

**Ftesë për Aplikim për Trajner për Drejtorët e Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta  
Programi "Shkollat e shekullit 21" British Council, Kosovë**

|                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|--------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Data</b>                                                        | 13 dhjetor 2019                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Rreth British Council</b>                                       | <p>British Council është organizatë ndërkombëtare e Mbretërisë së Bashkuar (MB) për marrëdhënie kulturore dhe arsim. Ajo ka për qëllim mobilizimin dhe ndërtimin e besimit për MB përmes këmbimit të njohurive dhe ideve mes njerëzve në mbarë botën. Organizata synon arritjen e qëllimeve të saj duke punuar në fushën e arsimit, shkencës, qeverisjes, gjuhës angleze dhe artit. Në vitin 2012-13 programet e British Council arritën një audiencë prej 550 milion njerëzve në mbarë botën dhe ishim të përfshirë në ndërveprim të drejtpërdrejt me 10.8 milion njerëz. E themeluar në vitin 1934, organizata British Council u themelua me Statut Mbretëror në vitin 1940. Është e regjistruar si organizatë bamirëse në Angli dhe Uells (numri i bamirësisë 209131) dhe Skoci (numri i bamirësisë SCO37733). British Council është po ashtu organ publik ekzekutiv jo qeveritar, pranë Ministrisë për Punë të Jashtme dhe Çështje të Commonwealth-it si ministri sponsorizuese.</p> <p>Qëllimet kryesore të aktiviteteve bamirëse të saj janë të përfshira në Statut dhe janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i marrëdhënieve kulturore dhe njohjes së kulturave të ndryshme në mes njerëzve, si dhe njerëzve të Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të tjera;</li> <li>• Promovimi i njohurive rreth Mbretërisë së Bashkuar;</li> <li>• Zhvillimi i njohurive të gjuhës angleze;</li> <li>• Inkurajimi i bashkëpunimit kulturor, shkencor, teknologjik dhe bashkëpunimeve të tjera në fushën e arsimit në mes Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të tjera;</li> <li>• Si dhe promovimi i avancimit të arsimit.</li> </ul> <p>British Council vepron në më shumë se 110 vende të botës dhe ka mbi 7000 punonjës. Selia e saj gjendet në MB, me zyrat në Londër, Mançester, Belfast, Kardif dhe Edinburg.</p> <p>Më shumë informacione mund të gjeni në <a href="http://www.britishcouncil.org">www.britishcouncil.org</a></p> |
| <b>Emri i projektit dhe objektiva e përgjithshme</b>               | <p>Programi 'Shkollat e shekullit 21'</p> <p>Përmirësimi i cilësisë së arsimit fillor në vendet e Ballkanit Perëndimor</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Qëllimi i projektit</b>                                         | Zhvillimi i shkathtësive të mendimit kritik, zgjidhjes së problemeve dhe kodimit tek nxënësit e moshës 10 deri në 15 vjeç në vendet e Ballkanit Perëndimor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Rezultati relevant i projektit që mbështetet nga kjo detyrë</b> | Drejtorët e shkollave e mbështesin në mënyrë aktive zbatimin e shkathtësive të mendimit kritik, zgjidhjes së problemeve dhe kodimit në nivel shkolle, në kurrikulën shkollore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Kohëzgjatja e projektit</b>                                     | Data e fillimit të projektit: tetor 2018<br>Data e përfundimit të projektit: shtator 2021                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Plani kohor, kohëzgjatja dhe vendi i detyrës</b>                | Janar 2020 – qershor 2021<br>4-8 ditë punë për çdo cikël trajnimi. Gjithsej gjatë kohëzgjatjes së projektit, nga muaji mars 2019 deri në qershor 2021, do të organizohen pesë cikle trajnimi. Një cikël trajnimi për një periudhë shkolle. Ju lutemi, vini re se disa nga trajnimet do të mbahen gjatë fundjavës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |

**Konteksti dhe  
mjedisi /  
/Fokusi  
/Fushëveprimi  
/Specifikimi**

## **Konteksti**

Programi “Shkollat e shekullit 21” është frymëzuar nga konkluzioni se arsimi duhet të jetë në vijën e parë të zhvillimit ekonomik në Ballkanin Perëndimor. Në të ardhmen, supozohet se tregu i punës do të ofrojë vende të reja pune për të cilat punonjësve do t’ju nevojiten shkathtësi të reja, si mendimi analitik dhe inovacioni, mendimi kritik, zgjidhja e problemeve komplekse etj. Shumë të rinj në Ballkanin Perëndimor përfundojnë shkollimin pa i përfituar shkathtësitë e kërkuara nga punëdhënësit. Në disa sektorë, përfshirë atë digjital, ka vende të lira punë që nuk plotësohen. Në të njëjtën kohë, ndryshimet në teknologji po ndodhin shumë shpejt, dhe mësimdhënësit hasin në vështirësi në përdorimin me efikasitet të teknologjisë për të përmbushur nevojat e nxënësve për mësim. Shkollave po ashtu u mungon infrastruktura digjitale për ta mbështetur përdorimin në rritje të teknologjive të reja në arsim dhe nevojën për zgjidhje të përballueshme. Mësimi i kodimit përmes informatikës fizike, përmes përdorimit të pajisjeve micro:bit, është mënyrë e përballueshme për ta mbështetur zhvillimin e këtyre shkathtësive tek nxënësit. Dizajnuar dhe pilotuar nga British Council dhe financuar nga qeveria e MB-së, ky program arsimi ambicioz do të zbatohet gjatë një periudhe tri vjeçare në vendet e Ballkanit Perëndimor. Projekti bazohet në përvojat e fituara nga projekti pilot i filluar në vitin 2017. Programi fokusohet në prezantimin e shkathtësive kryesore, pra mendimit kritik, zgjidhjes së problemeve dhe kodimit në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat fillore të mesme të ulëta në vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Serbi, Mali i Zi dhe Kosovë. Programi i ri, “Shkollat e shekullit 21”, sjell aktivitete të pilotuara në projektin e mëparshëm, por në shkallë më të gjerë. Pritet që 27,330 mësimdhënës të trajnuar dhe 4,500 drejtorë shkollash t’i pajisin deri në një milion të rinj me shkathtësi praktike të kodimit, mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, dhe të mbështesin zhvillimin e një mjedisi që ofron mundësi për plotësimin e mangësive në sferën e shkathtësive digjitale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke i angazhuar të gjithë 10 - 15 vjeçarët në sistemin e shkollave fillore në vendet e Ballkanit Perëndimor, programi mbështet zhvillimin e shkathtësive konkurruese për futje në tregun e punës në të ardhmen.

## **Fokusi i detyrës:**

Deri më tani, një numër i mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave nga shkollat fillore të mesme të ulëta në Kosovë janë trajnuar për integrimin e shkathtësive të zgjidhjes së problemeve, mendimit kritik dhe kodimit në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

British Council është në kërkim të trajnerëve shtesë nga Kosova për ofrimin e trajnimeve për drejtorët e shkollave fillore për mënyrën e integritit të shkathtësive kryesore (në radhë të parë mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve) dhe shkathtësive të kodimit (përmes përdorimit të pajisjes [micro:bit](#)) në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, bazuar në [kursin fillestar të shkathtësive kryesore të British Council](#).

## **Fushëveprimi:**

### **Procesi i validimit (i ofruar nga British Council)**

Kandidatët e përzgjedhur do të kenë të drejtën e mbajtjes së trajnimit për drejtorët e shkollave pasi të kenë:

- kryer detyrat e dhëna para trajnimit të trajnerëve
- marrë pjesë në punëtorinë dy-ditore të trajnimit të trajnerëve
- përgatitur dhe prezantuar një sesion të mësimdhënies si pjesë e procesit të trajnimit.

### **Ofrimi i trajnimeve për drejtorët e shkollave:**

- përgatitja dhe ofrimi i trajnimeve nga 4-8 ditë për çdo periudhë shkollore për integrimin e shkathtësive kryesore dhe të kodimit për grupin e përbërë afërsisht nga 30 drejtorë shkollash, në bashkëpunim me British Council
- monitorimi, mbështetja dhe mentorimi i drejtorëve të shkollave për të integruar shkathtësitë kryesore dhe kodimin në aktivitetet jashtë kurrikulare dhe ndër kurrikulare.

**Rezultatet**

- trajnimi i drejtorëve të shkollave në bashkëpunim me British Council
- ofrimi i rekomandimeve dhe këshillave specifike për drejtorët e shkollave, në lidhje me integrimin e shkathtësive kryesore dhe të kodimit në nivel shkolle
- dërgimi i raporteve në British Council

**I raporton:**

Koordinatorit kombëtar të projektit në British Council

**Vendi i ofrimit të shërbimit:**

Republika e Kosovës

**Ekspertiza**

Trajneri (-ja) kombëtar duhet të ketë ekspertizë, njohuri dhe përvojë relevante në ofrimin e shërbimeve të kërkuara, duke përfshirë:

**E domosdoshme:**

- të paktën 5 vite përvojë pune në ofrimin e trajnimeve për drejtorët e shkollave
- përvojë në mentorim dhe në ofrimin e përkrahjes për drejtorët e shkollave filllore të mesme të ulëta për integrimin e shkathtësive të reja në shkollë
- njohuri të mira për sistemin e arsimit në vend
- njohuri mira të gjuhës angleze
- të flasë rrjedhshëm të paktën një nga gjuhët lokale në të cilën do të mbahet trajnimi: shqip, turqisht, boshnjakisht/serbisht.

**E dëshirueshme:**

- Përvojë në përshtatjen e materialeve të trajnimit

**Përgjigja e aplikuesit**

Ju lutemi, dërgoni **CV-në tuaj** dhe **Përgjigjen ndaj kërkesës** të plotësuar në: **[Diellza.Rizvanoli@ks.britishcouncil.org](mailto:Diellza.Rizvanoli@ks.britishcouncil.org)** deri më datë **27.12.2019**, në orën **17:00**.

**Kriteret e vlerësimit:**

Kriter vendimtar për këtë Thirrje për kuotim është përvoja relevante. Aplikantët do të vlerësohen përmes kriterëve dhe vlerësimeve në vijim:

| Kriteret                                                  | Vlerësimi       |
|-----------------------------------------------------------|-----------------|
| Refuzimi mandator dhe opsional                            | Kalon/Nuk kalon |
| Seksioni 1 - Përgatitja, njohuritë dhe përvoja            | 60%             |
| Seksioni 2 - Njohuri rreth qëllimeve/objektivave të BC-së | 10%             |
| Seksioni 3 – Kostot/Çmimi                                 | 30%             |

Vlerësimi i të gjitha përgjigjeve të dorëzuara do të bëhet nga paneli vlerësues, i përbërë nga përfaqësues të British Council me përvojë relevante dhe të konsiderueshme dhe njohuri të kërkesave.

Vlerësimi i të gjitha aplikimeve do të marrë në shqyrtim vetëm informacionet e paraqitura në përgjigje. Marrëdhëniet e mëparshme/tanishme me furnitorët nuk mund të merren parasysh gjatë vlerësimit të aplikimeve, përveç nëse përvoja e mëparshme/tanishme është e evidentuar qartë në përgjigje. Vlerësimi do të jetë i drejtë dhe transparent.

Përgjigjet nën secilin seksion do të vlerësohen me pikë sipas matricës në vijim:

| Pikët | Interpretimi                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 15    | Përgjigje përmbledhëse dhe e fuqishme që tregon se aplikanti është plotësisht i aftë dhe me përvojë për të ofruar rezultatet e kërkuara. Përgjigje e detajuar, drejtpërdrejt i përgjigjet të gjitha kërkesave me shumë qartësi dhe janë ofruar shembuj relevantë.                    |
| 12    | Ka shqetësime të vogla se aplikanti nuk do të jetë në gjendje të arrijë rezultatet e kërkuara dhe përgjigja nuk përmban detaje të përvojës relevante. Një përgjigje më pak e detajuar, që i përgjigjet në vija të trasha kërkesës, me paqartësi dhe pak shembuj relevantë të ofruar. |

|                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  |
|---------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|                                             | 10                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Ka shqetësime se aplikanti nuk do të jetë në gjendje të arrijë rezultatet e kërkuara dhe përgjigja në mënyrë të konsiderueshme ka mungesë të detajeve për përvojën relevante. Një përgjigje më pak e detajuar që i përgjigjet në vija të trasha kërkesës, me paqartësi dhe pa shembuj ose shembuj jorelevantë të ofruar. |  |
|                                             | 5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Ka indikacione serioze se aplikanti nuk do të jetë në gjendje të arrijë rezultatet e kërkuara dhe nuk ka ofruar evidencë të përshtatshme të përvojës për ofrimin me sukses të rezultateve të kërkuara. Përgjigje jo tërësisht relevante për kërkesën, jo e qartë dhe me mungesë të detajeve specifike.                   |  |
|                                             | 0                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Përgjigja nuk i përgjigjet kërkesës dhe/ose nuk janë pranuar informacione relevante që tregojnë se aplikanti mund të arrijë rezultatet e kërkuara. Nuk ka përgjigje ose përgjigja është tërësisht jorelevante.                                                                                                           |  |
| <b>Kushtet e përgjithshme të angazhimit</b> | <p>Në fund, rezultati final i vlerësimit do të llogaritet për secilën përgjigje duke i mbledhur pikët për secilin seksion.</p> <p>“British Council beson se të gjithë fëmijët kanë potencial dhe çdo fëmijë, kudo në botë, është i rëndësishëm. British Council mbështet qëndrimin se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e abuzimit, siç parashihet në nenin 19, UNCRC, 1989”.</p> <p>Secili nga trajnerët e përzgjedhur do të nënshkruajë një Kontratë Shërbimi menjëherë pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes. Në rast të largimit nga programi 20 ditë para trajnimit tashmë të caktuar, trajneri duhet t'i rimbursojë British Council koston individuale që lidhet me trajnimin e validimit.</p> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  |